

VENDIM
Nr. 295, datë 20.4.2016

**PËR KALIMIN NË PËRDORIM TË BASHKISË TIRANË TË PRONËS ME NR. 619,
PASURIA 7/187, TË NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8380, PËR NJËSINË
ADMINISTRATIVE TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “i”, 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përdorim të Bashkisë Tiranë, të pronës me nr. 619, pasuria 7/187, të ndodhur në zonën kadastrale 8380, me sipërfaqe 28 897 (njëzet e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë) m², për Njësinë Administrative Tiranë, për ndërtimin e një parkimi nëntokësor, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
617			Truall	Parteret e Lanës Ura Lab-Ura D.Kombit			Shërbim	Bashkia	Nd.nr.1	Jane kthyer ne zone te gjelber
618	8150 Q-11,12 P-12	1/116,117, 118,122, 123,124	Truall	Lana+ pjesa e gjelber Ura Lab-Ura D.Kombit	9020		Shërbim	Bashkia	Nd.nr.1	
619	8380 PQ-11	7/187	Truall	Lulishte Parku Rinia	28897		Shërbim	Bashkia	Nd.nr.1	
620	8380 Q-11	7/132	Truall	Lulishte Shallvaret	1215		Shërbim	Bashkia	Nd.nr.1	
621	8270 Q-11	3/34	Truall	Lulishte Vëllezërit Frashëri	5070		Shërbim	Bashkia	Nd.nr.1	
622	8270 R-11	3/86	Truall	Lulishte Kuvendi Popullor	1720		Shërbim	Bashkia	Nd.nr.1	
623	8160 R-12	1/31	Truall	Lulishte Hotel Rogner	1056		Shërbim	Bashkia	Nd.nr.1	
624	8270 R,S-11,12	3/147	Truall	Lulishte (në krah) Presidencë	3900		Shërbim	Bashkia	Nd.nr.1	